

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e –II–
KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR

Procesverbal Nr. 83
nga mbledhja publike e mbajtur më **2.10.2007**
kryesuar nga **Rifat Krasniç**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 11,00

Të pranishëm :

- | | | |
|-------------|--------------------|--------------|
| 1. Rifat | KRASNIÇ | kryetar |
| 2. Lulzim | ZENELI | nënkryetar-I |
| 3. Jusuf | SUTAJ | |
| 4. Shaban | HALIMI | |
| 5. Zyhrrie | MALOKU | |
| 6. Berat | LUZHA | |
| 7. Sadudin | BERISHA | |
| 8. Afrim | ARZUALLXHIU | |
| 9. XHelal | CANZIBA | |
| 10. Fetah | BERISHA | |
| 11. Gazmend | MUHAXHERI | |
| 12. Selvije | HALIMI | |

Munguan :

- | | | |
|-----------|-------------------|-----------------|
| 13. Goran | BOGDANOVIĆ | -nënkryetar-II- |
| 14. | | |

TË FTUARIT : nga MMPH Ministri Ardian Gjini, Jashar Kastrati dhe Tirana
Baftiu

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Ministri Gjini rreth ndërtimeve në Mitrovicën veriore.
3. Vazhdimi i shqyrtimit të p/l për Shitjen e banesave.

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi hapi mbledhjen duke përshëndet anëtarët e komisionit dhe të ftuarit ministrin Ardian Gjini, konstatoi se lidhur me pikën 1 nuk ka vërejtje.

Ministri Ardian Gjini rreth ndërtime të Qeverisë së Serbisë në Mitrovicën Veriore

Kryetari Rifat Krasniç përshëndeti ministrin dhe sqaroi arsyen e ftesës së ministrit në këtë mbledhje duke kërkuar nga ai sqarime së pari për gjendjen aktuale në Mitrovicë.

Ardian Gjini shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin me këtë komision dhe në fillim konstatoi se tema për të cilën është ftuar për të dhënë sugjerime është e rëndë dhe delikate. Ai vazhdoi duke elaboruar për propozimet e Ramadan Kelmendit në seancën plenare dt.27.7.2007 rreth ndërtimeve ilegale në Mitrovicën Veriore të cilat sipas tij shumica e këtyre propozimeve nuk janë të realizueshme por sa i përket ndërtimeve ato mund të quhen si të tilla , sikurse ndërtimet anekënd Kosovës që cilësohen si ilegale. Për këto ndërtime ky komision ka punuar një ligj mjaft të mirë e cila pritet të nënshkruhet nga PSSP, të cilin ligj MMPH përkrah me ndryshimet që janë bërë nga ky komision. Ai theksoi se MMPH ka identifikuar këto prona në Mitrovicë mirëpo institucioni i vetëm kompetent për këto çështje është komuna e Mitrovicës bashkë me KFOR-in dhe UNMIK-un, pasi të hartoi një raport komuna e Mitrovicës do të shihet se çka mund të veprohet në këtë drejtim.

Berat Luzha potencoi faktin se këtu kemi të bëjmë me një specifikë të veçantë : një Qeveri e huaj financon në Kosovë për rikolonizim , ndërtime ilegale dhe ripopullëzim. Në fund pyeti pse nuk i lejohet edhe popullatës shqiptare kthimi në trojet e veta.

Ardian Gjini ritheksoi dhe këmbënguli se këto çështje janë të natyrës politike për çka mund të flitet tërë ditën në këtë komision, por çështje profesionale këtu nuk ka në masën më të madhe.

Sadudin Berisha shprehu pajtimin se kufizimi i kompetencave kufizon administrimin e situatës nga MMPH dhe Qeveria por assesi nuk e ndalon, ngase këtu kemi dy gjëra : legaliteti dhe ilegaliteti. Qeveria është ajo e cila duhet të alarmoi apo të njoftoi se çfarë duhet të ndërmerret në të ardhmen, sepse kështu gjërat ndodhin në heshtje. Institucionet tona duhet të nxjerrin përfundime legale nëse asgjë tjetër, e deri te alarmimi i administratës së OKB-së në New York (nëse ka nevojë), përndryshe si tha ai “ nuk mundet të më bind dikush se nuk mund të ndërhyjë askush në këtë kolonizim të heshtur “ ngase së paku duhet të bëhet gjykimi politik nga Qeveria e Kosovës, ndërtimet ilegale në Mitrovicën Veriore i bënë një Qeveri , jo një individ, përfundoi ai.

Ardian Gjini tha se MMPH asnjëherë nuk do të ketë shansin me ndërhy në punët e komunës, por duhet të pritet të nënshkruhet ligji i miratuar në këtë Kuvend dhe të rregullohet gjendja e çrregulluar, ngase në pjesën jugore ka më tepër ndërtime ilegale sesa në pjesën veriore, sikurse kudo në Kosovë. Ai insistoi se Qeveria për këtë çështje duhet të rekomandohet nga Parlamenti.

Jusuf Sutaj theksoi se ky komision nuk ka shënime sa banesa janë shitur apo ndërtuar atje por sqaroi se Kuvendi mund të nxjerr një rezolutë lidhur me këtë qytet e cila është e pakontrolluar nga ana jonë që nga viti 1999, është shumë më tepër e komplikuar gjendja

në këtë pjesë të Kosovës se sa mund të shprehet me fjalë, dhe gjithnjë e më tepër po na largohet nga kontrolli, këtë duhet të stopojmë disi, përfundoi ai.

Ardian Gjini u pajtua se përgjegjësia e Qeverisë së Kosovës nuk mund të anashkalohet si thotë edhe Sadudin Berisha, por potencoi se Qeveria nuk ka hesht, gjithashtu janë alarmuar ndërkombëtarët në krye me z. Galluqi etj. Ai propozoi që komisioni të rekomandoi një seancë plenare për këto synime të Sërbisë (mos të fokusohen si ndërtime ilegale, ngase gjithkund në Kosovë ka ndërtime të tilla), ndaj theksoi dhe përfundoi “nëse dini diçka ma mirë të sugjeroni, vetëm urdhëroni”.

Fetah Berisha ishte i mendimit se pa u rregulluar statusi i Kosovës nuk rregullohet çështja e Mitrovicës. Ai mbështeti ministrin për atë se në këtë rast përgjegjësi ka më tepër Qeveria.

Berat Luzha nuk përjashtoi përgjegjësinë e MMPH ngase Qeveria është deshtë të reagoi. Ai u pajtua me vërejtjet e Sadudin Berishës.

Pasi që u largua ministri Gjini **Afrim Arzuallxhiu** pyeti komisionin për rekomandimin e mundshëm nga kjo mbledhje për kryesinë e Kuvendit.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Synimet e Sërbisë në Mitrovicën Veriore nuk mund të kualifikohen si kompetencë e këtij komisioni, ngase në këtë pjesë të Kosovës kemi të bëjmë me problem politik.
2. Kryesia e Kuvendit të Kosovës mund të caktojë një pikë të veçantë për një seancë plenare për çështjen e Mitrovicës ose të kërkojë nga Qeveria e Kosovës, Komuna e Mitrovicës dhe UNMIK-u të marrin masa paraprake për ndalimin e veprimeve të mëtejme nga ana e Sërbisë që kanë të bëjnë me rikolonizim dhe ripopullim të kësaj pjese të Kosovës.

Projektligji për Shitjen e Banesave

Projektligji vazhdoi të shqyrtohet nga komisioni nga neni 19 aty ku ka mbetur komisioni në mbledhjen e fundit. Komisioni shqyrtimin e përfundoi me 23 amendamente të cilat do të hartohen me shkrim. Për shkak se përfaqësuesi i OSBE-së mungonte, komisioni nuk shqyrtoi komentet e tyre për këtë projektligj.

Të ndryshme

Kryetari hapi diskutimin rreth ndalesës së vizitave të komisioneve nga ana e kryesisë së Kuvendit, sepse ky komision ka ngecur në përgatitjet rreth konferencës rajonale, si dhe për projektligjin e ushqimit për të cilin kryesia ka kërkuar rezultate nga dy komisionet funksionale deri 10 tetor. Komisioni nxori:

P Ë R F U N D I M

- **Kryetari i Komisionit të angazhohet rreth realizimit të vizitës së paraparë më 8.10.2007 dhe 9.10.2007 në Shqipëri, në bashkëpunim me Kryetarin e Kuvendit.**

- Me Komisionin për Shëndetësi të mbahet mbledhja e përbashkët më 10.10.2007 në orën 13,00.

- Lidhur me diskutimet që do të zhvillohen nga anëtarët e komisionit në konferencën rajonale, u kërkuar që ato të fillojnë të përgatiten deri 18 tetor kur do të mbahet kjo konferencë.

Mbledhja përfundoi në orën 12,45

Bajram Badivuku z.l.l.

Kryetari i Komisionit,
Rifat Krasniç

